

**SHOQERIA RAJONALE UJESJELLES KANALIZIME
BERAT sh.a.**

**Pasqyrat Financiare më dhe
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025**

PËRMBAJTJA

FAQE

PASQYRAT FINANCIARE:

BILANCI KONTABËL	1
PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE	2
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	3
PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË	4
SHËNIME SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	5-21

SHOQERIA RAJONALE UJESJELLES KANALIZIME BERAT sh.a.
Pasqyra e Pozicionit Financiar për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025

(Shumat janë të shprehura në LEK)

	Shënime	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
AKTIVE			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	7	287,364,387	225,913,991
Investime		-	4,900,000
Llogari të arkëtueshme tregtare	8	419,104,378	429,534,576
Të tjera llogari të arkëtueshme	9	31,846,781	26,578,132
Inventarë	10	84,921,847	68,181,687
Parapagime dhe shpenzime të shtyra	11	221,126,378	220,636,649
Totali i aktiveve afatshkurtra		1,044,363,771	975,745,035
Aktivët afatgjatë			
Aktive afatgjatë materiale	12	4,160,135,030	4,003,730,756
Aktive afatgjatë jomateriale	13	590,309	787,079
Totali i aktiveve afatshkurtra		4,160,725,339	4,004,517,835
Totali i aktiveve		5,205,089,110	4,980,262,870
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Llogari të pagueshme tregtare	14	613,300,208	592,741,128
Të ardhura të shtyra	15	8,067,592	8,067,592
Detyrime tatimore	16	30,311,357	24,558,034
Parapagime të marra	17	530,701	498,074
Të tjera detyrime	18	139,250,290	157,027,653
Totali i detyrimeve afatshkurtra		791,460,148	782,892,481
Detyrime afatgjatë			
Hua afatgjatë	19	2,020,526,031	2,090,570,650
Llogari të pagueshme nga palët e lidhura	20	1,149,369,818	1,149,369,818
Grante dhe të ardhura të shtyra	21	1,179,866,244	902,238,056
Detyrime tatimore të shtyra	22	37,869,113	37,869,113
Totali i detyrimeve afatgjatë		4,387,631,206	4,180,047,637
Totali i detyrimeve		5,179,091,354	4,962,940,118
Kapitali			
Kapitali i nënshkruar	23	10,000,000	10,000,000
Fitime të mbartura		7,322,752	5,486,793
Fitimi i ushtrimit		8,675,004	1,835,959
Totali i kapitalit		25,997,756	17,322,752
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		5,205,089,110	4,980,262,870

Bilanci kontabël duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri në 21 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

SHOQERIA RAJONALE UJESJELLES KANALIZIME BERAT sh.a.
Pasqyra e rrjedhës së parasë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025

(Shumat janë të shprehura në LEK)

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit		394,784,545	343,181,689
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit		8,340,516	31,787,571
Total të ardhura	24	403,125,061	374,969,260
Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe të tjera shpenzime	25	(52,842,944)	(14,174,038)
Lënda e parë, materiale të		(52,842,944)	(14,174,038)
1) konsumueshme			
2) Të tjera shpenzime		-	
Shpenzime të personelit	26	(269,945,798)	(240,385,575)
1) Paga dhe shpërblime		(231,952,806)	(206,702,463)
Shpenzime të sigurimeve		(37,992,992)	(33,683,111)
2) shoqërore/shëndetësore			
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	12,13	(84,621,061)	(84,925,955)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	27	(13,121,237)	(73,262,182)
Të ardhura të tjera		110,718	9,604,474
3) Interesa të arkëtueshme dhe të ardhura të tjera të ngjashme	28	110,718	9,604,474
Shpenzime financiare	29	27,501,148	33,687,386
Shpenzime interesi dhe shpenzime		(14,424,654)	(11,122,087)
1) të ngjashme			
2) Te ardhura të tjera financiare		41,925,802	44,809,473
Fitimi/humbja para tatimit		10,205,887	5,513,370
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	30	(1,530,883)	(3,677,411)
Shpenzimi aktual i tatimit mbi		(1,530,883)	(3,677,411)
1) fitimin			
2) Shpenzimi aktual i tatimit të shtyrë		-	-
Fitimi/humbja e vitit		8,675,004	1,835,959
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		8,675,004	1,835,959

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri në 21 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

SHOQERIA RAJONALE UJESJELLES KANALIZIME BERAT sh.a.
Pasqyra e rrjedhës së parasë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025

(Shumat janë të shprehura në LEK)

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024
<i>Flukset e parasë nga aktivitetet operative</i>		
Fitim / Humbja e vitit	8,675,004	1,835,959
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar	1,530,883	
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	84,621,061	84,925,955
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:		
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	10,061,549	(180,141,753)
Rënie/(rritje) në inventarë	(16,740,160)	(5,737,055)
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	7,004,157	274,566,126
Rënie/(rritje) në parapagime dhe shpenzime të shtyra	(489,729)	-
Rritje/(rënie) në parapagime të arkëtuara	32,627	254,323,258
Rritje/(rënie) në grante dhe te ardhura te shtyra	277,628,188	-
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit	-	4,521,853
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	372,323,580	434,294,343
<i>Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit</i>		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(240,828,565)	(318,003,105)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	(240,828,565)	(318,003,105)
<i>Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit</i>		
Rritje/(Rënie) në huatë afatgjate	(70,044,619)	-
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	(70,044,619)	-
Ndryshimi neto i mjeteve monetare	61,450,396	116,291,238
Mjetet monetare në fillim të periudhës	225,913,991	109,622,753
Mjetet monetare në fund të periudhës	287,364,387	225,913,991

7

Pasqyra e rrjedhës së parasë duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri në 21 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

SHOQERIA RAJONALE UJESJELLES KANALIZIME BERAT sh.a.**Pasqyra e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024***(Shumat janë të shprehura në LEK)*

	Kapitali i nënshkruar	Fitime të mbartura	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni financiar më 1 janar 2024	10,000,000	(2,124,804)	7,611,597	15,486,793
Transferim në fitime të mbartura	-	7,611,597	(7,611,597)	-
Fitim/Humbja e periudhes	-	-	1,835,959	1,835,959
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2024	10,000,000	5,486,793	1,835,959	17,322,752
Transferim në fitime të mbartura	-	1,835,959	(1,835,959)	-
Fitim/Humbja e periudhes	-	-	8,675,004	8,675,004
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2025	10,000,000	7,322,752	8,675,004	25,997,756

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri në 21 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

“Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Berat” sh.a. është një shoqëri aksionare e krijuar nga “Marrëveshja për krijimin e subjektit të kompetencave të përbashkëta” date 28 Shtator 2022 e lidhur ndërmjet Ministrise se Infrastruktues dhe Energjise dhe Bashkive Berat, Kuçove, Dimal, Poliçan dhe Skrapar. Marrëveshja është lidhur për transferimin e veprimtarive ekonomike të UK Berat-Kuçove, Dimal, Poliçan dhe Skrapar në kuadrin e riorganizimit të sektorit të furnizimit me ujë në zbatim të VKM 302 date 11 Maj 2022 dhe është miratuar me Vendimet e Këshillit Bashkiak perkates , Berat nr.68 daten 18 Tetor 2022, Kuçove nr.63 date 25 Tetor 2022, Dimal nr.56 date 17 Tetor 2022, Poliçan nr. 41 date 21 Tetor 2022 dhe Skrapar nr.60 date 24 Tetor 2022. Kjo marrëveshje perben aktin e themelimit të “Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Berat” sh.a., e cila do të përfaqësojë një subjekt të kompetencave të përbashkëta, siç parashikohet në ligjin 139/2015 “Për Veteqeverisjen Vendore” dhe do të kryejë veprimtarinë e furnizimit me ujë dhe largimin, grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura në zonat e shërbimit që mbulojnë territorin administrative të Bashkive Berat, Kuçovë, Dimal, Poliçan dhe Skrapar.

Shoqëria vepron në bazë të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2009 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” , në bazë të Statutit të saj dhe legjislacionit në fuqi.

Kapitali i nënshkruar i Shoqërisë më 31 Dhjetor 2025 ishte 10,000,000 LEK dhe zotërohet nga aksionerët Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) e cila zotëron 51% të aksioneve, Bashkia Berat e cila zotëron 23.01% të aksioneve, Bashkia Dimal e cila zotëron 5.39% të aksioneve, Bashkia Poliçan që zotëron 3.58% të aksioneve, Bashkia Kuçovë 12.32% dhe Bashkia Skrapar zotëron 4.70% të aksioneve.

Gjatë vitit 2025, kapitali aksionar nuk ka patur ndryshime. Kapitali i Shoqërisë është kapital i regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Struktura e kapitalit aksionar më 31 dhjetor 2025 dhe më 31dhjetor 2024 është detajuar në shënimin 23 të pasqyrave financiare.

Objekti kryesor i shoqërisë është shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij; mirëmbajtja e sistemit/sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm; prodhimi dhe/ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve; shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura; mirëmbajtja e sistemeve të ujërave të ndotura, si dhe të impianteve të pastrimit të tyre.

Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës për periudhën 1 Janar 2025 – 3 Nentor 2025 , janë znj. Rajmonda Shuka kryetar, znj. Mimoza Kurti anetar, znj. Arisa Toska anetar, z. Erald Shushari anetar, znj. Gerta Ismailaja anetar, znj. Elona Mistrovica anetar dhe z. Arben Musaj anetar.

Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës për periudhën 4 Nentor 2025 – 31 Dhjetor 2025 , janë znj. Fjoralba Jahupi anetar, znj. Mimoza Kurti anetar, z. Erald Shushari anetar, znj. Arisa Toska anetar, znj. Gerta Ismailaja anetar dhe z. Arben Musaj anetar

Administrator i shoqërise është z. Pelivan Sinaj.

Shoqëria është regjistruar si tatimpagues në Njësinë e Tatimpaguesve Degës së Beratit me numër identifikimi (NIPT) M235110020. Adresa e saj e regjistruar është Lagjja nr. 1, Rruga Antipatrea, objekti nr. 7, Shqipëri.

Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2025 është 338 punonjës (31 dhjetor 2024: 349 punonjës)

(Shumat janë të shprehura në LEK, përveçse ku shprehet ndryshe)

2. BAZAT E PËRGATITJES

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit (referuar ketej e tutje si SKK) dhe bazuar në Ligjin nr 25/2018 date 10 maj 2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare “ dhe në përputhje me politikat e grupit. Pasqyrat financiare janë përgatitur duke respektuar parimin e kostos historike dhe parimin e vijimësisë. Keto pasqyra financiare janë paraqitur në LEK, e cila është edhe monedha funksionale dhe raportuese e Shoqërisë.

2.1 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtuesit të ushtrojnë gjykimin, vlerësimin dhe supozimet që ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël dhe në shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati faktik mund të ndryshojë nga këto vlerësime. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken.

Në veçanti, informacioni mbi fushat më të rëndësishme të pasigurisë së vlerësimeve dhe gjykimeve kritike në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efekt më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra financiare duke patur parasysh thjeshtësinë kontabël të veprimeve të realizuara nga Shoqëria.

3. BAZAT E MATJES

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të parimit të kostos historike duke e kombinuar me elementë të metodave të tjera dhe parimit të të drejtave të konstatuara.

4. MONEDHAT FUNKSIONALE

Këto pasqyra financiare individuale janë paraqitur në LEK, e cila është edhe monedha funksionale dhe raportuese e Shoqërisë.

5. PËRDORIMI I VLERËSIMEVE DHE GJYKIMEVE

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtuesit të ushtrojnë gjykimin, vlerësimin dhe supozimet që ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël dhe në shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet faktike mund të ndryshojnë nga këto vlerësime. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken. Në veçanti, informacioni mbi fushat më të rëndësishme të pasigurisë së vlerësimeve dhe gjykimeve kritike në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efekt më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra financiare duke patur parasysh thjeshtësinë kontabël të veprimeve të realizuara nga Shoqëria.

6. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABEL

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

6.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset zyrtare të aplikueshme nga Banka e Shqipërisë për këmbimin e LEK-ut me USD dhe Euro më 31 dhjetor 2025 dhe më 31 dhjetor 2024 janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
US Dollar (USD)	82.46	94.26
Euro (EUR)	96.77	98.15

6.2 Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre, llogari të arkëtueshme, llogari tregtare të pagueshme dhe llogari të tjera të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to (për instrumentat jo të mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes), përveç siç përshkruhet më poshtë. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitet financiarë regjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të Shoqërisë mbi flukset monetare të aktivitetit financiar ose kur Shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë rreziqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën Shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare regjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të Shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat afatshkurtra me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së rrjedhës së parasë, mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përfshijnë depozita të pakushtëzuara me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit. Rakordimi i totalit të mjeteve monetare në arkë dhe në bankë me mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre është paraqitur në shënimin 7.

6. PËRMBLEDHJE TË POLITIKAVE KONTABËL (VAZHDIM)

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provigjoni për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna objektive se Shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar dhe vonesat në pagesa konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme duhet të zhvlerësohen. Shuma e provigjonit llogaritet si diferencë midis vlerës kontabël (neto) të aktivitetit dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë në njohjen fillestare dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Vlera e drejtë

Nuk ka politika të rëndësishme kontabël dhe paraqitje të aplikuara nga Shoqëria që të kërkojnë përcaktimin e vlerës së drejtë, për aktivet dhe detyrimet si ato financiare dhe ato jo financiare. Atje ku është e aplikueshme, informacion shtesë në lidhje me supozimet e bëra për përcaktimin e vlerës së drejtë është përfshirë në shënimet shpjeguese të aktivitetit apo detyrimit përkatës. Vlera e drejtë e vlerësuar e mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, e kërkesave për t'u arkëtuar dhe e detyrimeve për t'u paguar është e ngjashme me vlerën e tyre kontabël për shkak të maturimit të tyre afatshkurtër.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

6.3 Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Aktivitet afatgjata materiale maten me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi. Kostot përfshijnë shpenzimet që janë të lidhura direkt me blerjen e aktivitetit. Kur pjesë të një aktiviteti afatgjatë material kanë jetë të dobishme të ndryshme, ato llogariten si zëra të ndara (pjesë të rëndësishme) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit e ndonjë zëri të aktiveve afatgjata materiale janë përcaktuar duke krahasuar të ardhurat e marra nga nxjerrja jashtë përdorimit me vlerën kontabël (neto) dhe janë pasqyruar neto në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot vijuese

Kostoja e zëvendësimit të aktiveve afatgjata materiale është njohur në vlerën kontabël (neto) të pjesës në qoftë se është e mundur që në të ardhmen të mirat ekonomike të përfshira në atë pjesë do t'i vijnë Shoqërisë dhe kostoja mund të matet me besueshmëri. Kostot e shërbimeve të përditshme të aktiveve afatgjata materiale janë të njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve afatgjata materiale është llogaritur duke u mbështetur mbi jetën e dobishme të çdo pjese të një zëri duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes.

6. PËRMBLEDHJE TË POLITIKAVE KONTABËL (VAZHDIM)

Aktivitetet e marra me qira amortizohen me metodën lineare duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit. Toka nuk amortizohet.

Të gjitha aktivitetet e tjera amortizohen me metodën e vlerës së mbetur. Metodatat e amortizimit, jetë e dobishme dhe vlera e mbetur e pronave, pajisjeve dhe makinerive janë rishikuar në datën e raportimit.

Metodat e amortizimit dhe norma e amortizimit për periudhën aktuale dhe atë krahasuese janë si vijon:

Kategoria e aktivitetit	Metoda e amortizimit	Norma e amortizimit
Mobilje dhe orëndi	Mbi vlerën e mbetur	20%
Instalime teknike dhe makineri	Mbi vlerën e mbetur	10%
Pajisje informatike	Mbi vlerën e mbetur	25%
Ndërtime speciale	Mbi vlerën e mbetur	2.5%
Ndërtesa	Mbi vlerën e mbetur	2%
Mjete transporti	Mbi vlerën e mbetur	10%

6.4 Zhvlerësimi

i. Aktivitetet financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka evidencë objektive zhvlerësimi si rezultat i një ose më tepër ngjarjeve që kanë ndodhur pas njohjes fillestare të aktivitetit dhe që kanë patur një ndikim në flukset e ardhshme monetare të vlerësuarat të aktivitetit financiar dhe këto efekte janë të matshme në mënyrë të besueshme.

Një humbje nga zhvlerësimi në lidhje me një aktiv financiar të matur me kosto të amortizuar është llogaritur si diferencë mes vlerës kontabël (neto) dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të vlerësuarat të parasë duke i skontuar me normën origjinale efektive të interesit.

Në veçanti aktivitetet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitetet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të rrezikut kreditor. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivitetet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Aktivitetet jo financiare

Vlera kontabël (neto) e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna për zhvlerësim. Nëse ka të dhëna të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit. Vlera e rikuperueshme është vlera më e lartë ndërmjet vlerës së drejtë minus koston e shitjes dhe vlerës në përdorim. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e ardhshme monetare të pritshme skontohen në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi që reflekton vlerësimet aktuale të tregut të vlerës në kohë të parasë dhe rreziqet specifike të aktivitetit për të cilat parashikimet e flukseve të ardhshme monetare nuk janë rregulluar. Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël (neto) e një aktiviteti tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

6. PËRMBLEDHJE TË POLITIKAVE KONTABËL (VAZHDIM)

6.5 Provigjonet

Një provigjion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria nuk ka një detyrim aktual ligjor apo konstruktiv i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe është e mundur që të kërkojë flukse dalëse monetare për shlyerjen e tij. Provigjonet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për rreziqet që lidhen me detyrimin në fjalë.

6.6 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në përputhje me SKK 8 Të ardhurat. Asnjë e ardhur nuk njihet nëse ka pasiguri të lartë lidhur me arkëtimin e pagesës dhe matjen e kostove përkatëse.

Të ardhurat nga shitja e mallrave njihen kur janë plotësuar të gjitha kushtet e mëposhtme:

- Shoqëria ia ka kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet që lidhen me pronësinë e mallrave;
- Shoqëria nuk vazhdon të jetë e përfshirë në mënyrë të vazhdueshme në manaxhimin e mallrave në atë masë që tregon se ende zotëron titullin e pronësisë; si dhe nuk ka kontroll efektiv mbi mallrat e shitura;
- Shuma e të ardhurave mund të matet me besueshmëri;
- Është e mundur që përfitimet ekonomike që lidhen me transaksionin do të merren nga njësia ekonomike; dhe
- Shpenzimet e bëra ose që do të bëhen në lidhje me transaksionin mund të maten me besueshmëri

6.7 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesat për llogaritë rrjedhëse në bankë dhe fitimet nga kurset e këmbimit. Të ardhurat nga interesat njihen kur realizohen duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet financiare përfshijnë interesat nga huamarrjet dhe humbjet nga kurset e këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes (nëse ka). Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

6.8 Shpenzimet e tatimit mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës i cili njihet drejtpërdrejt në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm për t'u paguar mbi të ardhurat e tatueshme të vitit, duke përdorur normat tatimore të miratuara gjatë periudhës. Fitimi i tatueshem ndryshon nga fitimi neto që raportohet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve sepse ai përjashton zëra të të ardhurave dhe shpenzimeve që janë të tatueshme apo të zbritshëm në vite të tjerë dhe gjithashtu përjashton zëra që nuk janë kurrë të tatueshëm apo të zbritshëm. Detyrimi i shoqërisë për tatim fitimin e vitit llogaritet duke përdorur normat e tatimit të përcaktuara nga legjislacioni shqiptar për kontabilitetin në Shqipëri. Norma aktuale mbi fitimin është 15 %. Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Detyrimi tatimor i shtyrë njihet për tatimet e zbritshme ose të pagueshme për periudhat e ardhshme si rezultat i transaksioneve ose ngjarjeve të kaluara. Këto tatime lindin nga ndryshimet mes vlerave të njohura për aktivet dhe detyrimet në Pasqyrën e Pozicionit Financiar dhe njohjes së këtyre aktiveve dhe detyrimeve nga autoritetet tatimore, si dhe nga mbartja e humbjeve tatimore dhe e tatimit të zbritshëm të papërdorur.

SHOQERIA RAJONALE UJESJELLES KANALIZIME BERAT sh.a.
Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024
(Shumat janë të shprehura në LEK, përveçse ku shprehet ndryshe)

7. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe në bankë më 31 dhjetor 2025 dhe më 31 dhjetor 2024 paraqiten si vijon:

	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Mjete monetare në bankë	254,444,672	223,748,050
Mjete monetare në arkë	12,683,031	2,165,949
Garanci Bankare	19,323,019	-
Vlera monetare në tranzit	913,665	-
	287,364,387	225,913,999

Mjetet monetare në bankë përfshijnë llogaritë rrjedhëse në lekë dhe euro me të cilat Shoqëria kryen pagesat si dhe arkëton kërkesat nga të tretët. Shumat e shprehura në monedhë të huaj janë këmbyer në lekë duke përdorur kursin zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe janë rivlerësuar me kursin e dt 31.12.2025.

8. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogari të arkëtueshme më 31 dhjetor 2025 dhe më 31 dhjetor 2024 përbëhen si vijon

	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Klientë	473,888,087	484,318,285
Zhvlerësimi llogarive të arkëtueshme	(54,783,709)	(54,783,709)
	419,104,378	429,534,576

Llog. Klientë është e zhvlerësuar për klientët e vjetër , te transferuar ne vitin 2023 dhe perkatesisht klientë e viteve 2008-2009 është zhvlerësuar në masën 85% dhe llogaria klientë e viteve 2010-2011 është zhvlerësuar në masën 65% të vlerës së tyre. Shuma e zhvlerësuar është 54,783,709 LEK.

9. Të tjera llogari të arkëtueshme

Llogari të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2025 dhe më 31 dhjetor 2024 përbëhen si vijon

	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Te tjera te arketueshme		
Kërkesa debitore kredia KFW (Lushnja)	14,737,897	14,947,269
Personeli	8,654,966	8,427,800
Kapitali i nënshkruar i papaguar	4,900,000	-
Debitorë të tjerë	3,553,918	2,885,041
Parapagime të dhena	-	318,022
	31,846,781	26,578,132

10. Inventarë

Gjendja e inventarit më 31 dhjetor 2025 dhe më 31 dhjetor 2024, paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Produkt i gatshëm	612,851	577,736
Lënde e parë	86,192,598	69,487,553
Zhvleresimi inventarit	(1,883,602)	(1,883,602)
	84,921,847	68,181,687

Provizione per zhvleresime

Shoqëria ka të transferuar në llogarite e saj zhvleresim për inventarin me qarkullim të ngadalshëm në shumën 1,883,602 LEK. Për vitin 2025 nuk kemi njohje dhe përlogaritje të re për provizione.

11. Parapagime dhe shpenzime të shtyra

Parapagime dhe shpenzime të shtyra më 31 dhjetor 2025 dhe më 31 dhjetor 2024 përbëhen si vijon:

	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Parapagime	489,729	-
Shpenzime të shtyra	220,636,649	220,636,649
	221,126,378	220,636,649

Shoqëria gjatë vitit 2024 ka krijuar shpenzime të periudhave të ardhme në Shumen 220,636,649 leke të cilat kanë të bëjnë me gjatësi dhe kumtvesonë të llogaritura nga OSHEE për detyrime të papaguara në vitet e mëparshme dhe të cilat shoqëria do të kalojë në shpenzime në periudhën kur do të kryejë pagesën e këtyre detyrimeve.

SHOQERIA RAJONALE UJESJELLES KANALIZIME BERAT sh.a.
Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024
(Shumat janë të shprehura në LEK, përveçse ku shprehet ndryshe)
12. AKTIVET AFATGJATA MATERIALE

Aktivet afatgjata materiale më 31 dhjetor 2025 dhe më 31 dhjetor 2024 përbëhen si vijon

	Toka, troje dhe terrene	Ndërtesa	Rrjete ujesjelles - kanalizime	Makineri dhe Pajisje	Mjete transporti	Pajisje informatike	Mobilje e pajisje zyre	Asete në proçes	Totali
Kosto									
Gjendja më 1 janar 2024	91,503,104	242,310,816	2,921,916,957	1,413,446,937	76,161,820	52,372,552	10,616,230	788,420,653	5,596,749,069
Shtesa	-	-	-	3,501,986	-	2,223,186	46,500	318,022,274	323,793,946
Pakësime	-	-	-	(21,600)	-	-	-	(5,771,672)	(5,793,272)
Gjendja më 31 dhjetor 2024	91,503,104	242,310,816	2,921,916,957	1,416,927,323	76,161,820	54,595,738	10,662,730	1,100,671,255	5,914,749,743
Shtesa	-	-	1,871,754	87,333	-	433,300	-	238,436,177	240,828,564
Transferime	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Pakësime	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2025	91,503,104	242,310,816	2,923,788,711	1,417,014,656	76,161,820	55,029,038	10,662,730	1,339,107,432	6,155,578,307
Amortizimi i akumuluar									
Gjendja më 1 janar 2024	-	72,282,970	984,440,706	704,837,518	32,631,181	25,167,785	6,997,663	-	1,826,357,823
Amortizimi i vitit	-	3,400,557	48,436,906	24,708,833	727,267	6,844,945	732,289	-	84,850,797
Pakësime	-	-	-	(189,633)	-	-	-	-	(189,633)
Gjendja më 31 dhjetor 2024	-	75,683,527	1,032,877,612	729,356,718	33,358,448	32,012,730	7,729,952	-	1,911,018,987
Amortizimi i vitit	-	3,332,546	47,227,449	23,493,228	4,270,404	5,512,419	588,245	-	84,424,290
Pakësime	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2025	-	79,016,073	1,080,105,061	752,849,946	37,628,852	37,525,149	8,318,197	-	1,995,443,277
Vlera neto kontabël									
Gjendja më 31 dhjetor 2024	91,503,104	166,627,289	1,889,039,345	687,570,605	42,803,372	22,583,008	2,932,778	1,100,671,255	4,003,730,756
Gjendja më 31 dhjetor 2025	91,503,104	163,294,743	1,843,683,650	664,164,711	38,532,968	17,503,889	2,344,533	1,339,107,432	4,160,135,030

Amortizimi i Aktiveve Afatgjata Materiale shoqëria nuk zbaton normat e nenit 51 të ligjit 29/2023, “Për Tatimin mbi të ardhurat”. , por zbaton norma të amortizimit të miratuar nga Këshilli Administrimit , përcaktohet që amortizimi të llogaritet me metodën vleres se mbetur dhe me norma të cilat janë të përafërta me jetëgjatësinë mesatare të përdorimit të tyre. Llogaritja e amortizimit është bërë për shumën 84,424,290 LEK, kontabilizuar edhe në shpenzime.

SHOQERIA RAJONALE UJESJELLES KANALIZIME BERAT sh.a.
Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024
(Shumat janë të shprehura në LEK, përveçse ku shprehet ndryshe)

13. Aktive afatgjata jomateriale

Aktivitet afatgjata jomateriale më 31 dhjetor 2025 dhe më 31 dhjetor 2024 përbëhen si vijon

	AAJM	Total
Me kosto		
Gjendja më 1 janar 2024	9,554,163	9,554,163
Shtesa	-	-
Pakësime	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2024	9,554,163	9,554,163
Shtesa	-	-
Pakësime	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2025	9,554,163	9,554,163
Zhvlerësimi akumuluar		
Gjendja më 1 janar 2024	8,504,724	8,504,724
Zhvlerësimi i vitit	262,360	262,360
Pakësime	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2024	8,767,084	8,767,084
Zhvlerësimi i vitit	196,770	196,770
Pakësime	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2025	8,963,854	8,963,854
Gjendja neto më 31 dhjetor 2024	787,079	787,079
Gjendja neto më 31 dhjetor 2025	590,309	590,309

14. Llogari të pagueshme tregtare

Të pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2025 dhe më 31 dhjetor 2024 përbëhen si vijon:

	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Furnitorë	613,300,208	592,741,128
	613,300,208	592,741,128

15. Të ardhura te shtyra

Të ardhurat e shtyra më 31 dhjetor 2025 dhe më 31 dhjetor 2024 përbëhen si vijon:

	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Të ardhura të shtyra	8,067,592	8,067,592
	8,067,592	8,067,592

16. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore më 31 dhjetor 2025 dhe më 31 dhjetor 2024 përbëhen si vijon:

	<u>31 dhjetor 2025</u>	<u>31 dhjetor 2024</u>
Tatimi mbi fitimin	440,266	5,405,226
TAP	4,075,311	318,336
TVSH e pagueshme	11,626,639	13,600,144
Sigurime shoqerore	8,952,494	-
Tatim ne burim	758,814	776,495
Tatime te tjera	4,457,833	4,457,833
	<u>30,311,357</u>	<u>24,558,034</u>

17. Parapagime te marra

Parapagime te marra më 31 dhjetor 2025 dhe më 31 dhjetor 2024 përbëhen si vijon:

	<u>31 dhjetor 2025</u>	<u>31 dhjetor 2024</u>
Parapagime	530,701	498,074
	<u>530,701</u>	<u>498,074</u>

18. Te tjera detyrime

Te tjera detyrime më 31 dhjetor 2025 dhe më 31 dhjetor 2024 paraqiten si me poshte .

	<u>31 dhjetor 2025</u>	<u>31 dhjetor 2024</u>
Paga te pagueshme	4,875,845	15,681,913
Detyrime te tjera	134,374,445	141,345,740
	<u>139,250,290</u>	<u>157,027,653</u>

	<u>31 dhjetor 2025</u>	<u>31 dhjetor 2024</u>
Detyrime te tjera		
taksa vendore Bashkia Berat	95,606,525	98,885,751
taksa vendore Bashkia Kuçovë	20,074,425	22,579,106
taksa ndertese Bashkia	10,291,734	10,291,734
taksa vendore Bashkia Dimal	7,748,580	9,589,149
te tjera	653,181	-
	<u>134,374,445</u>	<u>141,345,740</u>

19. Hua afatgjata

Huate afatgjata më 31 dhjetor 2025 dhe 31 dhjetor 2024 paraqiten sipas tabelës:

	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
KFW-Principali	558,122,380	607,295,747
KFW-Interesa	2,180,052	6,718,853
KFW-Rrjeti 2017	400,035,011	422,862,913
KFW - Furnizim me uje Berat-Kucove	1,024,253,854	1,024,253,803
Penalitete per kredin e KFW - Furnizimi me uje shqiperia mesme	35,934,734	29,439,334
	2,020,526,031	2,090,570,650

Shoqeria, ka konstatuar Detyrimet për huamarrje afatgjate ne vleren e mbetur 2,020,526,031 LEK specifikisht:

Kredi afatgjata

KFW në shumën **596,237,166 LEK**, te cilat përfaqëson hua afatgjatë, interesat dhe penalitetet deri me date 31 dhjetor 2025. Huaja afatgjate është marrë me kontratën e lidhur me datë 15/01/2003 midis Kreditantalt fur Wiederaufbau, Frankfurt (KFW), Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Agjensisë së Ekzekutimit të Projektit, Shoqëria e Ujësjiellës Berat-Kuçovë, për projektin "Furnizim me ujë Shqipëria e mesme". Shuma e huasë ishte 6,646,794.46 EUR. Kjo hua është përdorur për të financuar nxjerrjen, transmetimin dhe shpërndarjen e ujit të pijshëm. Sipas marrëveshjes së kredisë nënhuamarrësi, "Ujësjiellës Kanalizimi Berat-Kuçovë" sh.a. do ti paguajë Ministrisë së Financave një interes prej 0,75% në vit mbi të gjitha fondet e tërhequra dhe një komision angazhimi prej 0.25% në vit për pjesën e padisbursuar i cili do llogaritet mbi tepicën ditore të kredisë . Shlyerja e huasë do të bëhet me dy këste fikse prej 110,000 EUR për këtë në datat 30 Qershor dhe 30 Dhjetor të çdo viti duke filluar nga 30 Dhjetori i viti 2012 e deri më 31 Dhjetor të vitit 2042.

KFW në shumën **1,024,253,854 LEK**, përfaqëson aktmarrëveshjen e lidhur me KFW për projektin "Infrastruktura Bashkiake" në shumën 9,280,000 EUR. Kredia është dhënë për një periudhë 30 vjeçare , me shlyerje dy këste në vit në datat 30 qershor dhe 30 dhjetor dhe me periudhë pa pagesë interesi 10 vjeçare. Sipas marrëveshjes së nënhuasë të lidhur me Ministrinë e Financave kjo hua do të fillojë të shlyhet duke filluar nga data 30 Qershor 2022 dhe do të mbarojë më 31 Dhjetor 2051. Shuma e përdorur është 9,280,000 EUR .

KFW ne shumen **400,035,011 LEK** përfaqëson aktmarrëveshjen e lidhur me KFW për projektin "Rehabilitim I rrjetit" në shumën 4,700,000 EUR .

20. Llogari të pagueshme nga palët e lidhura

Detyrimet e shoqërisë në shumën 1,149,369,818 LEK përfaqësojnë detyrimet ndaj aksionereve të shoqërisë, dhe konkretisht;

	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Kontribut MIE	3,240,000	3,240,000
Kontribute Berat	868,633,090	868,633,090
Kontributet Skrapar	147,176,127	96,636,897
Kontributet Polican	33,683,704	33,683,704
Kontributet Dimal	96,636,897	147,176,127
	1,149,369,818	1,149,369,818

21. Grante dhe te ardhura te shtyra

Grantet rezultojnë në këtë pozicion të pasqyrave financiare në shumën 1,179,866,244 LEK. Në fund të vitit 2025 gjendja e granteve paraqitet si vijon:

	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Subvencion te ardhura nga AKUM	388,850,569	111,222,381
Rehabilitimi i rrjetit KFW 2017	541,705,998	541,705,998
Grant objekti devijim linja Bogove	436,721	436,721
Grant Dimal	3,581,969	3,581,969
Grant Polican	64,122,992	64,122,992
Grant Skrapar	129,810,449	129,810,449
Grante Afatgjatë	51,357,546	51,357,546
	1,179,866,244	902,238,056

22. Detyrime tatimore të shtyra

Në këtë pozicion të pasqyrave financiare rezultojnë edhe te ardhura te shtyra te transferuara nga UK Berat-Kuçove në Shumën 8,067,592 LEK si dhe Tatim fitimi I shtyre në Shumën 37,869,113 LEK.

23. KAPITALI FILLESTAR

Më 31 dhjetor 2025, kapitali fillestar ka vlerën 10,000,000 LEK dhe përbëhet nga 100,000 aksione me vlerë nominale 1,000 LEK. Bazuar në ligjin shqiptar për shoqëritë tregtare, 5% e fitimit vjetor, duhet të kalojë çdo vit në rezervë ligjore, deri sa rezerva të arrijë vlerën 10% të kapitalit aksionar. Gjatë vitit 2025 nuk ka patur ndryshime në kapitalin themeltar dhe as në krijimin e rezervave. Struktura e aksionerëve paraqitet si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025		Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024	
	Në %	Në vlerë	Në %	Në vlerë
MIE	51.00%	5,100,000	51.00%	5,100,000
Bashkia Berat	23.01%	2,301,000	23.01%	2,301,000
Bashkia Kuçove	12.32%	1,232,000	12.32%	1,232,000
Bashkia Dimal	5.39%	539,000	5.39%	539,000
Bashkia Poliçan	3.58%	358,000	3.58%	358,000
Bashkia Skrapar	4.70%	470,000	4.70%	470,000
TOTALI	<u>1</u>	<u>10,000,000</u>	<u>1</u>	<u>10,000,000</u>

24. Të ardhura nga shitja dhe të tjera

Të ardhurat nga shitja dhe te tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025 përbëhen si vijon:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024
Te ardhura nga shitjet	394,784,545	343,181,689
Te ardhura te tjera	8,340,516	13,315,200
Te ardhura nga grantet	-	18,472,371
	<u>403,125,061</u>	<u>374,969,260</u>

Njohja dhe vlerësimi i të ardhurave është bërë në bazë të SKK8 të përmirësuar, të Ardhurat janë vlerësuar me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar duke marrë parasysh zbritjet e ofruara nëse ka.

25. Lënda e parë, materiale të konsumueshme

Lënda e parë, materiale të konsumueshme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025 përbëhen si vijon:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024
Lëndë e parë	11,702,453	8,534,327
Energji elektrike	35,938,895	-
Lëndë djegëse - Karburant	5,201,596	4,690,865
Lëndë ndihmëse	-	948,846
	<u>52,842,944</u>	<u>14,174,038</u>

26 Shpenzime të personelit

Kostot e personelit përbëhen nga pagat dhe shpenzimet për sigurime shoqërore e shëndetësore:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024
Shpenzime paga	231,952,806	206,702,464
Shpenzime per sigurime shoqerore	37,992,992	33,683,111
	269,945,798	240,385,575

27 Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzime të tjera pasqyrojnë shpenzime për shërbime ndihmëse nga të tretë që lidhen drejtpërdrejtë me veprimtarinë e shfrytëzimit si dhe për qëllime administrative.

Shpenzimet e tjera më 31 dhjetor 2025 dhe më 31 dhjetor 2024 përbëhet si vijon:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024
Shpenzime udhetim e dieta	409,792	603,123
Shpenzime nga te trete	3,792,312	4,142,962
Shpenzime qira	886,766	814,613
Mirëmbajtje	633,206	547,000
Shpenzime komunikimi	924,098	962,726
Shpenzime bankare	249,490	202,714
Taksa të tjera	4,130,392	20,841,094
Shpenzime energji elektrike	-	30,164,328
Gjoba	203,934	14,981,622
Shpenzime te tjera	1,891,247	2,000
	13,121,237	73,262,182

28 Interesa të arkëtueshme dhe të ardhura të tjera të ngjashme

Të ardhura dhe shpenzime financiare më 31 dhjetor 2025 dhe më 31 dhjetor 2024 paraqiten si vijon:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024
Te ardhura interesi	(44,064)	(80,021)
Te ardhura te tjera financiare	-	(1,229,765)
Te ardhurat nga kamatvonesat	(66,654)	(8,294,689)
	(110,718)	(9,604,475)

29 Shpenzime financiare

Të ardhura dhe shpenzime nga kursi i kembimit më 31 dhjetor 2025 dhe më 31 dhjetor 2024 paraqiten si vijon:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024
Fitime të realizuara nga kurset e këmbimit	(42,396,867)	(46,036,100)
Shpenzime interesi	7,929,254	380,359
Shpenzime penalitet interesa kredi	6,495,400	10,741,728
Humbje të realizuara nga kurset e këmbimit	471,065	1,226,627
	(27,501,148)	(33,687,386)

30 Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin

Shoqëria është subjekt i tatim fitimit në Shqipëri, norma e tatim fitimit për vitin 2024 është 15%. Ligjet dhe rregullat tatimore shqiptare janë objekt interpretimi nga autoritetet tatimore. Në llogaritjen e tatim fitimit shoqëria ka zbatuar SKK11 të përmirësuar dhe ka zbatuar kërkesat e legjislacionit fiskal në fuqi.

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024
Fitimi para tatimit	10,205,887	5,513,370
Total shpenzime të panjohura	-	19,002,705
Shpenzime të tjera	-	19,002,705
Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)	10,205,887	24,516,075
 Tatim fitimi @15%	 1,530,883	 3,677,411
	8,675,004	1,835,959

31 ANGAZHIME DHE DETYRIME TË KUSHTËZUARA*Çështje gjyqësore*

Më 31 dhjetor 2025 dhe më 31 dhjetor 2024, Shoqëria nuk është përfshirë në procedura ligjore, pretendime dhe çështje gjyqësore me palët e treta. Drejtimi beson se çdo ngjarje e ardhshme e mundshme nuk do të ketë një ndikim material negativ mbi pozicionin financiar, rezultatin e operacioneve apo rrjedhën e parasë së Shoqërisë.

Detyrimet tatimore

Librat e shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025. Për rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në mënyrë të besueshme.

32 PALET E LIDHURA

Një transaksion me palët e lidhura është një transferim i burimeve, shërbimeve apo detyrimeve midis palëve të lidhura, pavarësisht nëse është caktuar një çmim. Njësitë konsiderohen si të lidhura, nëse njëra palë ose kontrollon palën tjetër, ose ka një influencë të ndjeshme mbi palën tjetër, ose kur kanë kontroll të përbashkët të një njësie tjetër ose kur është anëtar i personelit drejtues të njësisë apo të shoqërisë mëmë të saj (duke përfshirë familjarë të afërt të ndonjërit prej individëve të referuar më sipër). Kontrolli është pushteti për të drejtuar politikat financiare dhe operacionale të një shoqërie në mënyrë që të marrësh përfitime nga aktiviteti i saj. Kontrolli ekziston kur mëma, direkt ose indirekt, zotëron më shumë se gjysmën e të drejtave të votave, të shoqërisë bijë.

33 NGJARJE PAS DATES SE BILANCIT

Nga data 31 Dhjetor 2025 dhe deri në datën e aprovimit të Pasqyrave Financiare nuk ka ngjarje të tjera të rëndësishme të cilat kërkojnë rishikime ose ndryshime në këto pasqyra financiare. Aktiviteti i Shoqërisë ka vazhduar pa ndërprerje edhe gjatë muajve të parë të vitit 2026, dhe ka patur një performancë relativisht të qëndrueshme.

Drejtimi nuk është në dijeni për ndonjë pasiguri materiale apo ngjarje që janë materialisht të rëndësishme për tu paraqitur në këto Pasqyra Financiare, apo që mund të hedhë dyshime të konsiderueshme mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimës

Enrita Shkurt




